

LIGJ
Nr. 77/2018

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË DHE AGJENCISË SË BASHKIMIT EVROPIAN PËR
BASHKËPUNIMIN E ZBATIMIT TË LIGJIT, MBI VENDOSJEN
E OFICERIT NDËRLIDHËS TË EUROPOLIT**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë së Bashkimit Evropian për Bashkëpunimin e Zbatimit të Ligjit, mbi vendosjen e oficerit ndërlidhës të Europolit, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 1.11.2018

Shpallur me dekretin nr. 10943 , datë 9.11.2018, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

MARRËVESHJE

NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE AGJENCISË SË BASHKIMIT EVROPIAN PËR
BASHKËPUNIMIN E ZBATIMIT TË LIGJIT MBI VENDOSJEN E OFICERIT NDËRLIDHËS TË
EUROPOLIT

Republika e Shqipërisë, në vijim e referuar si “Shqipëria” dhe Agjencia e Bashkimit Evropian për Bashkëpunimin e Zbatimit të Ligjit, në vijim e referuar si “Europol”, në vijim, bashkërisht të referuara si “Palët” ose individualisht si “Palë”.

Neni 1

Oficeri ndërlidhës i Europolit

1. Shqipëria dhe Europolu bien dakord të rrisin bashkëpunimin, siç përcaktohet në Marrëveshjen për Bashkëpunimin Operacional dhe Strategjik ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Europolit, të nënshkruar më 9 dhjetor 2013 në Hagë (në vijim e referuar si “Marrëveshja”), nëpërmjet vendosjes së një ose më shumë oficerëve ndërlidhës të Europolit në Shqipëri.

2. Numri i oficerëve ndërlidhës të Europolit do të bihet dakord nga Shqipëria dhe Europolu.

Neni 2

Detyrat e oficerit ndërlidhës

Do të jetë detyra e oficerit/ëve ndërlidhës të Europolit për të mbështetur dhe për të bashkërenduar bashkëpunimin ndërmjet Shqipërisë, Europolit dhe Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian. Në veçanti, oficeri/ët ndërlidhës i/të Europolit do të jetë/në përgjegjës për mbështetjen e kontakteve ndërmjet Shqipërisë, Europolit dhe Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian dhe për lehtësimin e shkëmbimit të informacionit.

Neni 3

Statusi i oficerit ndërlidhës

1. Oficeri/ët ndërlidhës i/të Europolit konsiderohet/en si përfaqësues formal/ë i/të Europolit në lidhje me Shqipërinë. Shqipëria do të lehtësojë qëndrimin e oficerit ndërlidhës në territorin e Shqipërisë.

2. Shqipëria, brenda territorit të saj, i jep oficerit/ëve ndërlidhës të Europolit të njëjtat privilegje dhe imunitete si ato që Shqipëria u jep pjesëtarëve të stafit të misionëve diplomatike në Shqipëri, me gradë të ngjashme, në përputhje me Konventën e Vjenës mbi Marrëdhëniet Diplomatike, 18 prill 1961

3. Arkivat e oficerit/ëve ndërlidhës të Europolit janë të paprekshme nga çdo ndërhyrje e shtetit shqiptar.

Këta arkiva duhet të përfshijnë të gjitha shënimet, korrespondencën, dokumentet, dorëshkrimet, të dhënat digjitale, fotografitë, filmat dhe regjistrimet që i/u përkasin ose që mbahen nga oficeri/ët ndërlidhës.

Neni 4

Metodat e punës

1. Çdo shkëmbim informacioni ndërmjet Shqipërisë dhe oficerit ndërlidhës bëhet vetëm në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes.
2. Gjatë shkëmbimit të informacionit, oficeri/ët ndërlidhës i/të Europolit do të komunikojë/në me pikën kombëtare të kontaktit dhe me autoritetet kombëtare kompetente, siç është përcaktuar në Marrëveshje ose ndonjë subjekt tjetër i caktuar brenda Shqipërisë, i dedikuar për këtë qëllim.

Neni 5

Çështjet administrative

1. Oficeri/ët ndërlidhës i/të Europolit do të vendoset në Pikën Kombëtare të Kontaktit (Selinë), ku do t'i sigurohen të gjitha lehtësirat e nevojshme, si ambienti i zyrës dhe pajisjet e telekomunikacionit me shpenzimet e Republikës së Shqipërisë. Megjithatë, kostot e telekomunikacionit do të mbulohen nga Europolit.
2. Çdo pajisje e Europolit e instaluar në zyrën qendrore mbetet pronë e Europolit.
3. Europolit do të përjashtohet nga të gjitha tatimet doganore, ndalimet dhe kufizimet mbi importin dhe eksportin, në lidhje me mallrat për përdorim zyrtar.
4. Europolit do të sigurojë që oficeri/ët i/e tij ndërlidhës të ketë/kenë akses të shpejtë dhe kur është teknikisht e mundur, të kenë akses të drejtpërdrejtë në bazat e të dhënave të nevojshme për përmbushjen e detyrave të tyre. Oficeri ose oficerët ndërlidhës të Europolit mund të përdorin, kur është e përshtatshme, infrastrukturën ekzistuese për shkëmbimin e informacionit dhe për komunikimin ndërmjet Europolit dhe Shqipërisë.
5. Oficeri/ët Ndërlidhës i/të Europolit duhet të respektojë/në rregullat e sigurisë të shtetit shqiptar në masën që është e zbatueshme në lidhje me praninë e tij/saj në selinë qendrore, pavarësisht nga regjimi i sigurisë së Europolit, i zbatueshëm në veçanti për punëpunimin e informacionit të Europolit. Gjatë kryerjes së detyrave të tyre, oficeri/ët ndërlidhës të Europolit do të procedojë/ në përputhje me Rregulloren e Europolit.
6. Oficeri/ët ndërlidhës i/e Europolit do të informojë/në Shqipërinë për orarin e punës dhe detajet e kontaktit në rastet e emergjencës. Oficeri /ët ndërlidhës i/e Europolit do të informojë/në Shqipërinë për çdo mungesë të gjatë nga vendi i punës

Neni 6

Përgjegjësia në raste konflikti

1. Pavarësisht nga neni 21 i Marrëveshjes, Palët do të jenë përgjegjëse për çdo dëmtrim të shkaktuar ndaj pronës së Palës tjetër. Çdo dëmtrim i tillë do të shlyhet menjëherë nga njëra Palë, në bazë të një kërkesë të arsyetuar nga Pala tjetër. Në rast mosmarrëveshjeje në lidhje me një shlyerje, mund t'i referohet nenit 22 të Marrëveshjes.
2. Në rastet e konfliktit ndërmjet Shqipërisë dhe Europolit ose ndërmjet Shqipërisë dhe oficerit ndërlidhës të Europolit, Shqipëria ka të drejtë të ndalojë hyrjen në zyrat qendrore, të oficerit ndërlidhës të Europolit ose të japë një akses të tillë vetëm nën disa kushte ose kufizime të veçanta, në bazë të një justifikimi të arsyeshëm.
3. Kur ekziston një konflikt serioz ndërmjet Shqipërisë dhe oficerit ndërlidhës të Europolit, Shqipëria ka të drejtë t'i paraqesë një kërkesë Europolit për zëvendësimin e tij.

Neni 7

Ndryshimet

Ndryshimet në këtë marrëveshje do të bien dakord reciprokisht me shkëmbimin e notave ndërmjet Palëve.

Neni 8

Përfundimi

1. Kjo marrëveshje mund të përfundojë nga secila Palë pas njoftimit me shkrim tre muaj para.
2. Pa cenuar paragrafin 1, efektet ligjore të kësaj marrëveshjeje do të mbeten në fuqi.

Neni 9

Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën kur Republika e Shqipërisë njofton Europolin se procedurat e

brendshme të ratifikimit kanë përfunduar.

Nënshkruar në gjuhën shqipe dhe angleze në dy origjinale, ku secili tekst është njëloj autentik.

PËR REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Ardi Veliu

Drejtore i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit

Më 31.7.2018

PËR EUROPOLIN

Wil van Gemert

Zëvendës-drejtor Ekzekutiv i Operacioneve

Më 23.7.2018

AGREEMENT

Between the Republic of Albania and the European Union Agency for Law Enforcement Cooperation on the deployment of a Europol Liaison Officer

the Republic of Albania, hereafter referred to as "Albania"

and

the European Union Agency for Law Enforcement Cooperation, hereafter referred to as "Europol"

Hereinafter collectively referred to as the 'Parties' or individually as the 'Party'

Article 1 Europol Liaison Officer

1. Albania and Europol agree to enhance the co-operation as laid down in the Agreement on Operational and Strategic Cooperation between the Republic of Albania and Europol signed on 9 December 2013 in The Hague (hereinafter "the Agreement"), through the deployment of one or more Europol liaison officers to Albania.
2. The number of Europol liaison officers shall be agreed by Albania and Europol.

Article 2 Tasks of the Liaison Officer

It shall be the task of the Europol liaison officer(s) to support and co-ordinate the co-operation between Albania, Europol and the Member States of the European Union. In particular, the Europol liaison officer(s) shall be responsible for supporting contacts between Albania, Europol and the Member States of the European Union and for facilitating the exchange of information.

Article 3 Status of the Liaison Officer

1. The Europol liaison officer(s) shall be regarded as a formal representative of Europol with respect to Albania. Albania shall facilitate the stay of the liaison officer within Albania.
2. Albania, within its territory, shall grant to the Europol liaison officer(s) the same privileges and immunities as those accorded by Albania to members, having comparable rank, of staff of diplomatic missions established in Albania, in accordance with the Vienna Convention on Diplomatic Relations of 18 April 1961.
3. The archives of the Europol liaison officer(s) shall be inviolable from any interference by Albania. These archives shall include all records, correspondence, documents, manuscripts, digital data, photographs, films and recording belonging to or held by the liaison officer(s).

Article 4
Working methods

1. Any exchange of information between Albania and the liaison officer shall only take place in accordance with the provisions of the Agreement.
2. When exchanging information, the Europol liaison officer(s) shall communicate with the National Contact Point and the national competent authorities, as established in the Agreement or any other specified entity within Albania dedicated for that purpose.

Article 5
Administrative issues

1. The Europol liaison officer(s) will be based at the National Contact Point (the HQ) where all necessary facilities shall be arranged for, such as office space and telecommunications equipment at the costs of the Republic of Albania. The costs of telecommunication shall however be borne by Europol.
2. Any Europol equipment installed at the HQ shall remain the property of Europol.
3. Europol shall be exempt from all customs duties, prohibitions and restrictions on import and export in respect of goods for official use.
4. Europol shall ensure that its liaison officer(s) has speedy and, where technically feasible, direct access to the databases necessary for the fulfilment of their tasks. The Europol liaison officer(s) can make use, where appropriate, of the existing infrastructure for communication and information exchange between Europol and Albania.
5. The Europol liaison officer(s) shall comply with Albania's security rules insofar as applicable concerning their presence in the HQ, notwithstanding Europol's own security regime applicable in particular to the processing of Europol information. In performing their duties, the Europol liaison officer(s) shall proceed in accordance with the Europol Regulation.
6. The Europol liaison officer(s) shall keep Albania informed of their working hours and contact details in cases of emergency. The Europol liaison officer(s) shall also inform Albania of any extended absence from the HQ.

Article 6
Liability in cases of conflict

1. Notwithstanding Article 21 of the Agreement, the Parties shall be liable for any damages caused to the other Party's property. Any such damages shall be promptly repaid by a Party, on the basis of a duly substantiated request by the other Party. In case of disagreement concerning a repayment, Article 22 of the Agreement may be followed.
2. In cases of conflict between Albania and Europol, or between Albania and the Europol liaison officer(s), Albania shall be entitled to prohibit access to the HQ to the Europol liaison officer(s), or to grant such access only under particular conditions or restrictions, on the basis of a duly substantiated justification.
3. Where there is a serious conflict between Albania and the Europol liaison officer, Albania is entitled to submit a request to Europol for their replacement.

Article 7 Amendments

Amendments to this agreement shall be mutually agreed upon by exchange of letters between the Parties.

Article 8 Termination

1. This agreement may be terminated by each Party upon three months' written notification.
2. Without prejudice to paragraph 1, the legal effects of this agreement shall remain in force.

Article 9 Entry into force

This agreement shall enter into force on the date on which Albania notifies Europol that its internal ratification process has been completed.

Signed in Albanian and English languages, in two originals, each text being equally authentic.

For the **Republic of Albania**

For **Europol**

Ardi Veliu
General Director
Albanian State Police



On 31/7/2018

Wil van Gemert
Deputy Executive Director Operations

On 27/7/2018